



Npi – 01/17 datë: 13.02.2026

Duke u bazuar në nenin 12, 24, dhe 40.2 pika (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Nenin 62 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr.03/L-048; Qarkoren Buxhetore 2026/02 për Komuna; Propozimin e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa Nr.11/16 të datës 10.02.2026 për miratimin e Planit Buxhetor Komunal për vitin 2026; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më: 13.02.2026, mori këtë:

## V E N D I M

### PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË SHTIMES PËR VITIN 2026

#### I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më: 13.02.2026, unanimitisht miratoi Buxhetin e Komunës së Shtimes për vitin 2026, si vijon:

Nr.	Përshkrimi	Shuma në €
1	Pagat për vitin 2026 (me staf prej 752)	6,801,067
2	Mallra dhe Shërbime	1,500,000
3	Shpenzime Komunale	230,000
4	Subvencione dhe Transfere	500,000
5	Shpenzime Kapitale	2,412,918
Gjithsej Buxheti		<b>11,443,985</b>

#### II

Vendimi është aprovuar, pas procesit të diskutimit publik me qytetarë, me organizatat jo qeveritare, me subjektet politike, me grupet e interesit, si dhe duke marrë për bazë edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### III

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL

#### IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Ministrisë të Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Rahman Jakupi